

dldp – Shpërndarja e Njohurive dhe Përvojave në Fushën e Menaxhimit të Financave Publike:

Për Çfarë Bëhet Fjalë dhe Si Mund t'i Bashkoheni Kësaj Nisme!

OBJEKTIVAT

Qëllimi është ngritja e kapaciteteve të NJQV-ve në fushën e Menaxhimit të Financave Publike në bazë të praktikave të mira lokale e kombëtare, si dhe standarteve ndërkombëtare. Kuadri i përgjithshëm i politikave bazohet në përjasjen PSZHePBA që konsiston në:

Planet e Zhvillimit Strategjik (PSZH), (e) Instrumenti i Planifikimit Financiar dhe Programi i Buxhetor Afatmesëm(PBA). Kjo përjasje është plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor për buxhetin.

REZULTATE TË PRITSHME

Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike të ekspertëve të NJQV-ve, presim që NJQV-të partnere të arrijnë rezultatet e mëposhtme:

- Burime financiare të planifikuara, të shpenzuara dhe të kontrolluara për të mundur dhe ndikuar në ofrimin e shërbimeve publike efikase, efçente, transparente dhe të ndjeshme nga ana sociale. Instrumentet dhe metodologjia e planifikimit strategjik të zhvillimit janë të lidhura me Programin e Buxhetor Afatmesëm.
- Ndërgjegjësim më i lartë dhe përdorim më i gjerë i teknikave të avancuara dhe metodologjive të aplikuara në Menaxhimin e Financave Publike nga ekspertët e NJQV-ve.
- Transparencë e përmirësuar dhe pjesëmarrje e grupeve të interesit dhe komunitetit në planifikimin e politikave vendore dhe financimin e tyre(procesi i buxhetit).
- Rritje dhe optimizim i burimeve të financimit përmes hartimit të paketave fiskale realiste dhe transparente.
- Harmonizim si dhe shkëmbim ndërmjet nivelit lokal dhe kombëtar për përmirësimin e politikave dhe udhëzimeve të aplikueshme për pushtetin lokal.

METODOLOGJIA

Forcimi i kapaciteteve teknike të stafit të NJQV-ve do të mundësohet përmes një pakete trajnimesh të vazhdueshme bazuar përmbajtësisht në përjasje të testuara dhe të vërtetuar nga dldp-ja dhe partnerët e saj. Këto trajnime do të përfshijnë gjithashtu vizita në formën e udhëtimeve studimore, të mësuarit online dhe diskutime mbi politikat kombëtare e më gjerë.



EKSPERIENCA TË SUKSESSHME

“Njësitë e Qeverisjes Vendore të asistuar nga dldp po shkojnë drejt proceseve të standardizuara në menaxhimin e financave publike, vendimarrja mbi politikat dhe programet e financimit të tyre është përmirësuar

Stefan Pfaeffli
Konsulent i dldp-së



Adresa:

Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS", Kati i 2-të, nr. 3, | Tiranë | 1000 | Albania
L. Kongresi Përmëtit | Rruga Oso Kuka Nr.11 | Shkodër | 4000 | Albania
www.dldp.al | www.helvetas.org | E-mail: dldp@helvetas.org



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA

AKTIVITETET KRYESORE

Aktivitetet kryesore të planifikuara për tu organizuar me anë të grupit të ekspertëve ndërvendor janë:

Paketë gjithëpërfshirëse trajnimesh në fushën e Menaxhimit të Financave Publike (MFP): hartim i planeve strategjike, paketave fiskale, buxheteve vjetore dhe afat-mesme (sipas modele të asistuar nga dldp).

Raste studimore dhe rekomandime me objektiv reflektim të tyre në politikë dhe udhëzimet kombëtare, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë dhe agjencitë kryesore kombëtare.

- Përfshirja në dialogun e përmirësimit të decentralizimit fiskal, në bashkëpunim të ngushtë me aktorë dhe programe të tjera.
- Pjesëmarrje në vizita studimore dhe seminare mbi zhvillimin dhe shkëmbimin e praktikave të mira në Menaxhimin e Financave Publike dhe decentralizimit fiskal.
- Grante konkurruese mbi bazën e performancës së NJQV-ve në menaxhimin e financave vendore.

ÇFARË PRITET NGA NJQV-TË PARTNERE?

- Përvetësimi i modeleve të sukseshme dhe kontributi në zbatimin dhe shpërndarjen e tyre.
- Marrja pjesë në diskutimet për çështje të politikave nëpërmjet platformës së menaxhimit të njohurive.
- Mbulimi i kostove që lidhen me pjesëmarrjen në trajnime dhe seminare në Shqipëri.
- Pjesëmarrja rregullisht në aktivitete të organizuara nga grupi i ekspertëve ndërvendor në fushën e Menaxhimit të Financave Publike.
- Pilotimi i metodave të zhvilluara për arritjen e objektivave të performancës së NJQV në menaxhimin e financave publike dhe përmirësimi i mëtejshëm i tyre.
- Mbështetje e drejtëpërdrejtë nga lideshipi politik (kryetari dhe këshilli).

DOKUMENTE TË HARTUARA NGA dldp

Një gamë e gjerë e manualesh, udhëzuesish, materialeve trajnimi, praktikash të mira, modeleve dhe formatesh mund të gjenden në faqen e internetit www.dldp.al

- Planifikimi afatgjatë dhe afatmesëm strategjik dhe financiar. Një manual për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri (shqip dhe anglisht)
- Plani strategjik i zhvillimit dhe Buxheti Afatmesëm me bazë performancën. Një kurs trajnimi 5 ditor. (shqip dhe anglisht)
- Planifikimi Financiar Afatmesëm për qeveritë vendore në kontekstin e Shqipërisë. Manual për Instrumentin e Planifikimit Financiar në Excel PFF (shqip dhe anglisht)
- Plane Strategjike të Zhvillimit të lidhura me Programe Buxhetimi Afatmesëm, Programe të Planifikimit Financiar, paketa fiskale të disa NJQV-ve (shqip dhe anglisht)
- Praktika të mira, modele dhe formate në Menaxhimin e Financave Publike nga Qarqet e Shkodrës dhe Lezhës, Niveli Kombëtar dhe Nivel Ndërkombëtar (shqip dhe anglisht)

EKSPERIENCA TË SUKSESSHME

... ka raste të sukseshme në menaxhimin e financave publike në Njësitë të Qeverisjes Vendore. Një kontribut të konsiderueshëm në këtë drejtim kanë dhënë programet e huaja të asistencës, që ndihmojnë njësitë e qeverisjes vendore në hartimin e projekt-buxheteve dhe politikave kombëtare me rekomandime konkrete nga praktikantët vendore: një ndër me të suksesshmit është Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dldp).

Fran Brahimi

Drejtorja e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit
Ministria e Financave

BËHUNI PJESË E KËTIJ PROJEKTI

Për më shumë informacion për këtë paketë njohurish, ose për të mësuar më shumë për mënyrën e pjesëmarrjes, ju lutemi kontaktoni: Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim (dldp)

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS", Kati i 2-të, nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Tel. (+355)42269225 / (+355)22250999
E-mail: dldp@helvetas.org
www.dldp.al



Adresa:

Rr. Ibrahim Rugova, Godina e "PLUS", Kati i 2-të, nr. 3, Tiranë | 1000 | Albania
L. Kongresi Përmetit | Rruga Oso Kuka Nr.11 | Shkodër | 4000 | Albania
www.dldp.al | www.helvetas.org | E-mail: dldp@helvetas.org

dldp
decentralisation and local
development programme



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA